



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI"
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI"
Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	26.09.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-335

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. i ref. 01-_____

Prizren, me: ____/____/____

Bazuar në dispozitat e nenit 16 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 , si dhe vendimin e Këshillit Drejtues të Universiteti „Ukshin Hoti“ në Prizren nr. 01-111 , shpall:

KONKURS
PËR PUNË PRAKTIKE PËR STUDENTËT E UUHP-SË

Ftohen studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren që të aplikojnë për punë praktike në administratën e Universitetit.

Puna praktike ka si objektiv që t'ju ofrojë studentëve mundësi që dijen teorike të nxënë gjatë studimeve, ta aplikojnë në praktikë, duke krijuar përvojë të punës në administratë, si staf mbështetës në njësitë administrative të UUHP-së.

Numri i pozitave: 10 praktikantë.

Kohëzgjatja e punës praktike : 3 muaj

Kriteret për përzgjedhjen e studentëve për punë praktike:

- Kandidatët për punë praktike duhet të jenë studentë së paku në vitin e dytë apo të kenë të përfunduar studimet në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren (bachelor dhe master).
- Në përzgjedhjen e studentëve për punë praktike, komisioni do të marrë parasysh notën mesatare të studimeve.
- Praktikanti/ja preferohet të ketë: Shkathtësi të komunikimit; aftësi të mira analitike, Shkathtësi dhe njohuri në aplikimin e programeve kompjuterike nga pako Microsoft Office dhe shkathtësi në punë teknike; Aftësi të punës në grupe.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe mënyra e aplikimit

Kandidatët me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

1. Kërkesën për shprehje interesi,
2. CV-në,
3. Certifikatën e notave,
4. Kopjen e diplomës ose certifikatës së diplomës
5. Kopjen e letërnjoftimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë.

- Data për aplikim është nga 26.09.2019 deri më 04.10.2019 në ora 16:00.
- Shpallja e listës me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni ad hoc do të bëhet me datën 07.10.2019.
- Studentët e përzgjedhur për punë praktike, do të nënshkruajnë kontratën e angazhimit me Universitetin.
- Dokumentet duhet të dorëzohen në formatin elektronik pdf në e-mail adresën: apliko.upz@uni-prizren.com.
- Studentët do të jenë të angazhuar me orar të plotë sipas rregullores 05/2010 (08:00-16:00)
- Praktika për studentët e përzgjedhur do të zgjasë tre muaj (3 muaj), në periudhën tetor - dhjetor 2019.

Kandidatët që nuk pranohen kanë të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave që funksionon në kuadër të administratës së Universitetit.

Inkurajohen që të aplikojnë të gjithë studentët e UUHP-së pa kurrfarë dallimi, respektivisht të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Praktikantët në përfundim të punës praktike do të pajisen nga Universiteti "Ukshin Hoti" me: Referencë dhe Certifikatë.

Burim Berisha
Sekretari i Përgjithshëm